



Pranuar / Dostizuar Proposed / Pre dato Received / Delivery	31.12.2020	0	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Agency Org / Inst	Nr Prot Pr. No	Shënim a Emërg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIAMSHICK	3379/2020		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr405/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër ANr.405/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], përmes përfaqësuesit të autorizuar avokati [REDACTED] me adresë rruga "UCK" Kompleksi Qafa kati I-Nr.5 në Prishtinë, kundër organit të punësimit- Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për Këshillim dhe votim, me datë 31.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e pa lejuar ankesa më numër ANr.405/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

A r s y e t i m

[REDACTED] e punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në vendin e punës "Zyrtare e Statistikave të Ambientit", sipas Akt emërimit të datës 11.04.2012, me datë 14.07.2020 ka parashtruar kërkesë tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për ngritjen e koeficientit nga (6) në koeficientin (7), duke pretenduar se përshkrimin e detyrave të punës e ka të ngarkuar dhe i plotëson kushtet për koeficientin 7, sepse bënë grumbullimin e të dhënave, përpilimin e raporteve vjetore dhe raporteve EDAMIS për Statistikat e Ujërave, pasi i ka 20 publikime të publikuara në Departamentin e Arsimit dhe Departamentin e Mjedisit.

Ankuesja me datë 08.12.2020, për shkak të heshtjes administrative ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi nuk ka pranuar përgjigje nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, duke pretenduar se i ka plotësuar kushtet për ngritjen e koeficientit nga (6) në koeficientin (7), duke kërkuar që ti bëhet pagesa me koeficientin 7 në bazë përvojës, dhe përgatitjes profesionale, si dhe ti behet pagesa diferencës në mes koeficientit 6 dhe 7 në mënyrë retroaktive nga dita që i ka plotësuar kushtet me koeficientin 7 që në vazhdimësi të paguhet me këtë koeficient.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 14.12.2020, ka dërguar tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, kërkesën për përgjigje, ndërsa me datë 21.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, numër protokolli 3212/2020 të bashkangjitur me shkresat e lëndës.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 3013/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akte emërim i datë 11.04.2012; Përshkrimi i detyrave të punës 03.10.2013; Kërkesa e datës 14.07.2020; Përgjigje në ankesë e datës 21.12.2020 nr. protokolli 3212/2020; Rregullorja e brendshëm e Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Organogrami i datës 01.01.2013, me pozita të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimi, ka konstatuar se ankesa e ankueses ██████████ është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesja me datë 14.07.2020 ka parashtruar kërkesë tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për ngritjen e koeficientit nga (6) në koeficientin (7), për shkak të përshkrimit të detyrave të punës të ngarkuar, kurse me datë 08.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se i ka plotësuar kushtet për ngritjen e koeficientit nga (6) në koeficientin (7), në bazë përvojës së punës dhe ngritjes profesionale, prandaj Kolegji konstaton se ankesa është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave për heshtje administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja, ka parashtruar kërkesë me datë 14.07.2020 tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kurse me datë 08.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për mes përfaqësuesit të autorizuar, me numër protokolli 3013/2020, për shkak të heshtjes administrative të Agjencisë së Statistikave të Kosovës gjegjësisht Kryeshefit Ekzekutiv, e që kjo ankesë është parashtruar jashtë afatit ligjor, të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: 4. *“Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, prandaj Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe si e tillë është e pa lejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.Nr.405/2020

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit / ██████████ (për ankuesen ██████████)
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe Arkivit të KPMSHCK-së.